STS-PSA-INFO

SCHWEIZER TIERSCHUTZ STS · PROTECTION SUISSE DES ANIMAUX PSA · PROTEZIONE SVIZZERA DEGLI ANIMALI PSA

Hunde / Chiens / Cani
Albanisch / Albanais / Albanese

Fletë udhëzuese mbajtja e qenve

Jeta mesatare: 12-15 vite

Shpenzimet

Kafsha	300-4000 CHF	Varësisht nga raca dhe origjina
Shpenzimet fillestare	500-1000 CHF	Enë për ushqim dhe ujë, litarë, lidhëze për qafë, shportë, kafaz për transport, shpenzimet e veterinerit për tredhje (kastrim), vaksinat, heqja e krimbave, çipi obligues, regjistrimi dhe dëshmia obligative e kursit mbi njohurin e lëmisë
Shpenzime vjetore	përafërsisht 1000 CHF	Varësisht nga madhësia e qenit: ushqimi, taksa për qen, shpenzime të rregullta të veterinerit për vaksinim dhe heqje krimbash, qëndrim në pansion për qen gjatë pushimeve
Të tjera	Shpenzimet e jashtëzakonshme të veterinerit mund ta kalojnë shumë çmimit të blerjes së qenit.	

Koha e duhur

Qentë duhet të kenë mundësi të jetojnë me familjet e tyre, në "tufën e tyre njerëzore. Përveç kësaj ata kanë nevojë çdo ditë për disa orë përkujdesje të plotë dhe për shëtitje të theksuar nëpër rrugë me shumë variacione, ushtrimet edukuese me anë të lojës dhe ballafaqimi i hundës, veshëve dhe të trurit, si p.sh. lojëra kërkimi. Qenët nuk duhet të lihen vetëm më gjatë se 4 orë. Qentë si kafshë shtëpiake janë të papërshtatshme për të punësuarit me orar të plotë, veç nëse qeni ka mundësi të merret me vete në vendin e punës dhe të lëviz atje i lirë. Përveç kësaj qentë kanë nevojë edhe për shumë kohë, për kurse edukimi. Pronarët e ardhshëm duhet të informohen thellësisht tek specialistët dhe me literaturën e lemisë para se të marrin vendimit për një qen.

Një mal me nene ligjore

Mbajtja e qenve në Zvicër është shumë e komplikuar. Mbajtësit e qenve duhet të respektojnë shumë rregullore të ndryshme. Së pari kemi një legjislacion të përgjithshëm për mbrojtjen e kafshëve zviceran, i cili përcakton kushtet minimale për mbajtjen e adekuate sipas llojit dhe sjelljen e duhur e kujdesshme me qenë. Legjislacioni i përgjithshëm për mbrojtjen e kafshëve përmban në vete gjithashtu rregullore për kultivimin (rritjen) e qenve dhe për përdorimin e mjeteve ndihmëse për edukim. Për shembull qaforet me thumba dhe qaforet edukuese, të cilat funksionojnë me anë të ngacmimit elektrik dhe aromave janë të ndaluara në Zvicër. Përveç kësaj shkurtimi i veshëve dhe i bishtit është i ndaluar në Zvicër, po ashtu edhe importimi i qenve me vesh dhe bisht të shkurtuar (prerë), me dy përjashtime: qenët me shkurtime të tilla munden të merren me vete në Zvicër vetëm si mall shpërngulje dhe për qëllime të qëndrimit turistik.

Në Zvicër mbajtësit e qenve duhet të vijojnë kursin obligativ mbi njohurit e lëmisë: 4 orë kursi teorik për mbajtësit fillestarë të qenve, pa përvojë me qenët, 4 orë të kursit praktik, për secilin qenë të ri, pavarësisht se nga origjina e qenit (nga strehimorja për kafshë, kultivuesi, nga vendet e jashtme...). Adresat e trajnerëve të

njohur, të cilët mund të lëshojnë këtë dëshmi të kursit mbi njohurit e lëmisë, mund ti gjeni tek; http://bvet.bytix.com/plus/trainer/. Në Zvicër është gjithashtu e obligueshme që qenve ti vendoset një çip dhe që ata të regjistrohen, dhe kjo bëhet tek regjistri qendrorë www.anis.ch. Zakonisht veterineri i injekton çipin dhe e regjistron qenin nën emrin e pronarit të qenit.
Përveç ligjit të përgjithshëm zviceran, gati secili kanton ka një ligj vetanak për qenë. Ligjet kantonale për qen mund të ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra. Në disa kantone disa raca janë të ndaluara, derisa në disa kantone vlen edhe vendosja obligative e turizës për rasa të veçanta etj. Një përmbledhje e ligjeve kantonale për qenët mund të gjendet në: www.tierschutz.org (në gjuhën përkatëse të kantonit). Nëse ju jeni të pasigurte në lidhje me legjislacionin për qenë në kantonin tuaj, atëherë duhet që ju ta kontaktoni entin kompetent kantonal për veterinë. Ju lutem të vini re: nëse në Zvicër kaloni kufijtë kantonal, duhet të keni parasysh si mbajtës i qenit ligjet përkatëse, të cilat janë të vlefshme për atë kanton. Për çdo rast duhet të keni gjithnjë me vete një litarë, një turizë (në të cilën është adaptuar qeni) dhe dokumentacionin përkatës (librezën e vaksinimit (imunizimi) të kafshës, dëshminë mbi njohurit e lëmisë etj.).
Ne Zvicër kërkohen nga Bashkitë taksa për qenë. Secili mbajtës i qenit duhet të regjistroj qenin e tij në Bashki dhe të paguaj taksa për kafshën. Taksa për qenë ndryshon në mes 40 CHF deri në 150 CHF për një vit. Me anë të këtyre (taksave) Bashkitë ndër të tjerat financojnë kontejnerët e mbeturinave dhe qeset e plasmanit ("Sistemi Robidog"), me të cilat mbajtësit e qenve duhet të mbledhin jashtëqitjen e kafshëve të tyre.

Qen race ose racë e përzier? Këlysh ose qen i rritur? Zagar ose bushtër/kudër?

Përparësia e qenit të racës qëndron aty, se është e njohur se si do të duket qeni njëherë dhe çfarë tipare themelore do të priten prej kësaj qenie. Përmes rritjes së njëanshme njeriu has megjithatë në sëmundjet e shpeshta trashëguese te qentë e racës. Andaj n nuk janë për tu rekomanduar qentë e racës, tiparet e të cilëve janë zhvilluar në mënyrë ekstreme p.sh. qeni shkurtabiq, hundë e shtypur, koka e madhe, këmbët e shkurta. Sëmundjet trashëguese mund të paraqiten edhe te racat e përziera. Të kujdesurit për një qen të vogël është një gëzim i madh, mirëpo kërkon punë dhe kohë intensive. Në javët dhe muajt e parë duhet mbi të gjithash të vizitohen kurse të veçanta për krijimin e individualitetit të këlyshëve. Me vonë për qentë e ri të seksit mashkullor janë më se të nevojshme kurset edukuese. Qentë e seksit mashkullor mund ta zhvillojnë më mirë një sjellje, qëndrim dominant ndaj njerëzve si dhe ndaj qenve tjerë se sa kudrat. Prandaj duhet jo vetëm tek qenët e seksit mashkullorë, por edhe tek të gjitha llojet e qenve pasur kujdes , që ata të edukohen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe konsekuente. Bushtrat/Kudrat janë dy herë në vit me epshe shtimi. Për t'ju shmangur brezit të ri, ajo nuk duhet të lihet asnjëherë e pa vrojtuar gjatë kohës së epshit – shtëpitë për kujdesin e kafshëve të braktisura janë plot me qen të tepërt! Veterineri gjegjësisht veterinerja ju jep me gjithë qejf informata mbi shtypjen e epshit përkatësisht tredhjen/kastracionin.

Ku të blihen? Çka të merret parasysh?

Shumë qen, të ri dhe të rritur, presin një vatër të re në shtëpitë për kujdesen e kafshëve të braktisura të organizatave për mbrojtjen e kafshëve. Personeli i shtëpive për kujdesjen e kafshëve të braktisura këshillon mbajtësit e ardhshëm të qenve në mënyrë kompetente. Shumica e shtëpive japin vetëm qen të vaksinuar, shumica të tredhur me pagesën kundër një kontributi të veçantë dhe me një kontratë. Nëse duhet të jetë një qen race prej kafshërritësit (kultivuesi), duhet që të vizitohen shumë kultivues dhe të krahasohen kushtet, në të cilat janë rritur qenët. Në Zvicër ekzistojnë dy shenja për mbajtje të kontrolluar të qenve, etiketa e artë e kontrollit të cilësisë dhe „Certodog". Këlyshët duhet të ndahen nga nënat dhe vëllezërit dhe motrat e tyre vetëm kur ti kenë mbushur 10-12 javë. Kujdes me këlyshët e lirë të dorëzuar nga tregtarët e qenve nga kultivimi i pakontrolluar. Kushtet e mangëta për rritjen e kafshëve të një „prodhimi" të tillë „masiv" qojnë shumë herë deri tek të metat në të sjellur dhe deri tek problemet shëndetësore.
Hiqni dorë plotësisht nga blerja e kafshëve përmes internetit! Kafshët e ofruara përmes internetit shpesh kanë origjinën nga prodhimtaria masive dhe kultivohen (rriten) në kushte të tmerrshme të mbajtjes. Gjithashtu edhe tregtia (trafiku) ilegale me kafshë bëhet përmes shpalljeve falas në internet, dhe mashtrimet janë po ashtu prezentë.

Hunde / Chiens / Cani
Albanisch / Albanais / Albanese

Çfarë ju nevojitet qenve?

Qentë kanë nevojë një deri dy herë në ditë për ushqim, këlyshët më shpesh, dhe gjithmonë për ujë të freskët. Ju mund ta ushqeni qenin tuaj me ushqim të gatshëm ose me ushqim të përgatitur vetë, gjatë së cilës duhet të përzihet një copë mish dhe një pjesë amidoni (nisheste). Të ashtuquajturat „objekte përtypëse janë të mira për higjienën e dhëmbëve. Tek eshtrat ekziston rreziku i mbylljes së zorrëve. Qentë kanë nevojë për kujdesje intensive sipas gjatësisë së leshit të gëzofit, në mënyrë që të mos shpupurishet gëzofi. Megjithatë qentë nuk duhet të lahen rregullisht dhe as të shamponohen, jashta nëse janë të zhytur shumë. Mbajtja në zinxhir ose në kafaz nuk ju përgjigjet nevojave të qenve dhe është për tu refuzuar. Në Zvicër fatkeqësisht ende mund të mbahen qenët nën një zinxhirë lëvizës, maksimalisht në ditë 19 orë. Legjislacioni mbi mbrojtjen e kafshëve parasheh madhësinë minimale të kafazit, varësisht nga pesha, për shembull 2 qenë me nga 20-25 kg peshe trupore duhen të kenë në dispozicion më së paku 8 m^2 sipërfaqe toke në kafaz, përveç kësaj një shtëpizë të izoluar dhe strehë të thatë. Legjislacioni mbi mbrojtjen e kafshëve në Zvicër kërkon që mbajtësit e qenve të shëtisin çdo ditë qenin e tyre jashtë sipas nevojave të tija, dhe ti mundësojnë atij kontakte adekuate me qenë të tjera dhe me njerëz. Kjo vlen gjithashtu edhe për qenë të cilët mbahen në kafaze dhe në zinxhirë. Qentë duhen të kenë mundësi të pastrohen disa herë ne ditë mbi dheun e natyrës. Është e vetëkuptueshme që të mblidhet jashtëqitja e qenve dhe të hidhet në mbeturina. Nëse bëhen shëtitjet e përditshme vetëm në rrugët e qytetit, duhet të hiqet dorë prej mbajtjes së qenve. Shëtitjet e përbashkëta kanë një kuptim edhe më të gjerë, se sa që supozohet. Qeni duhet të ketë mundësi të përmbush nevojën e tij për lëvizje, të shfryhet, të hulumton mjedisin me shqisat e veta dhe të luan, në rast ideal së bashku edhe me qen të tjerë. Gjatë shëtitjeve mund të bëhen me qenë edhe ushtrime edukuese në formë loje (thirrjet, kujdesia, ecja në këmbë, ndryshimi i anës etj.) dhe të ballafaqohet qeni me lojë, të cilat nxisin aftësitë e tija mentale dhe natyrore, si për shembull përcjellja e aromave ose kërkimi i ushqimit të fshehur.

Edukata

Çdo qen ka nevojë në njëfarë mase për edukim. Ai duhet të mëson që të mos kërcen mbi njerëz, që të mos tërheq litarin, që të mos zemërohet kur ti kërkohet prej tij që të zbres prej kolltukut. Gjatë kursit mbi njohuritë e lëmisë përkatëse pronarët e qenve mësojnë në shkollën e qenve dhe në kurset për edukim se si ata të bëhen të kuptueshëm qartazi ndaj qenët, dhe të arrin synimet e veta në mënyrë të përzemërt por konsekuente. Zanafilla e sjelljeve të padëshiruara duhet të kërkohem më parë tek pronari se sa te qeni. Pronarët e qenve para blerjes së qenve duhet që intenzivishtë të merren me bazat e sjelljes së llojit të qenve dhe me edukimin modern dhe të përshtatshëm të përkëdhelurit tyre të ri.

Problemet e sjelljes

Lehja e pandërprerë, agresiviteti, sjellje e pakontrolluar e gjuetisë, tërheqja e litarit dhe probleme të tjera në sjellje nuk janë kurrfarë shkaku që kafsha të dërgohet në strehimoren për kafshë. Specializantë të terapisë së sjelljeve dhe psikologë të kafshëve i ndihmojnë mbajtësit e qenve, për të përmirësuar mbajtjen e qenit dhe të sjellurit me qen, si dhe për ti pasur nën kontroll problemet me anë të trajnimeve dhe metodave të ndryshme terapeutike, me një shkallë suksesi deri në 80 %. Këshillime në lidhje me problemet e sjelljes ofrojnë në veçanti veterinerë të specializuar në mjekësin e sjelljes (www.stvv.ch) dhe këshilltari psikologë i kafshëve (www.vieta.ch).

Përkujdesje veterinare

Qentë duhet të vaksinohen për çdo vit dhe t´u hiqen krimbat shpesh. Veterineri gjegjësisht veterinerja bën vaksinimin e duhur dhe kështu kontrollon rregullisht edhe gjendjen shëndetësore të qenit.

Qentë dhe pushimet

Kur të udhëtoni për pushime, është e mirë për qenin që të ketë mundësi t`ju shoqëroj. Mirëpo duhet të zgjidhen hotele gjegjësisht vendqëndrime pushimi që janë të përshtatshëm për qen. Qentë nuk bën të lihen mbrapa në makinë. Qysh në pranverë mund të ngrihen temperaturat në një makinë deri në 80° Celsius, edhe nëse janë dritaret pak të hapura – një kurth për kafshë me pasoja mizore

deri në vdekje! Si alternativë ata edhe mund të strehohen në një pension për kafshë ose në një shtëpi për përkujdesjen e qenve të braktisur, kjo kushton 25-50 franga në ditë. Lëshimi i kafshëve në rrugë është i dënueshëm dhe mund të ndëshkohet me një gjobë deri në 20 000 franga.

Qentë dhe fëmijët

Qentë mund të jenë për fëmijët partner dhe shokë të shkëlqyer. Mirëpo fëmijët nuk mund të kujdesën në mënyrë të vetanake për një qen. Përgjegjësia për mbajtjen dhe edukim përkatës sipas llojit si dhe udhëzimi dhe mbikëqyrja e fëmijëve në sjelle me qenin qëndron tek prindërit. Fëmijët e vegjël nuk bën të lihen vetëm me qen.

Informacionet dhe vendet kontaktuese

- Broshura: „Hunde“ (qentë) (gjermanisht, frëngjisht, italisht), „Augen auf beim Hundekauf“ (Sytë hapur gjatë blerjes së qenit) (gjermanisht, frëngjisht); Udhëzues i Mbrojtjes Zvicerane të Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS), mund të porositen falas me njëzarf C5 të pajisur me pullë dhe të adresuar në vetvete. Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, Postfach, 4008 Basel, këshillim (gjermanisht, frëngjisht, anglisht) dhe porositje e materialit Tel. 061 365 99 99, Faksi: 061 365 99 90, sts@tierschutz.com, www.tierschutz.com, këshillim falas (gjermanisht, frëngjisht, anglisht), broshura falas, adresa të strehimoreve për kafshë, klubi i fëmijëve www.krax.ch
- „Kind und Hund“ (fëmiu dhe qeni), „Spielend vom Welpen zum Hund“ (duke luajtur prej këlyshëve deri te qeni), „Hunde verstehen – Signale rechtzeitig sehen“ (kupton qentë – sheh sinjalet me kohë) (gjermanisht), botime të veçanta të magazinës zvicerane për qen (Schweizer Hunde Magazin), merren falas me një zarf B4- të pajisur me pullë dhe të adresuar në vetvete nga Mbrojtja Zvicerane e Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS).
- Broshurë informative falas “Hunde – Tiere richtig halten” (Mbajtja e duhur e qenëve – kafshëve”, “Ich möchte einen Hund” (Unë dua një qen), “Ich halte einen Hund” (Unë mbaj një qen), “Hundenachwuchs?” (Këlyshët e qenve), “Ich habe Angst vor Hunden” (Kam frikë nga qenët), “Reisen mit Hund und Katze” (Udhëtimi me qen dhe mace); Libër për mënjanimin e kafshimit nga qenët tek fëmijët “Tapsi komm...”/ “Vieni Birillo...” / ”Truf, viens...” (Këlyshë eja...) (gjermanisht, frëngjisht, italisht), botohen nga Enti Federal për Veterinë BVET. Mund të porositën fals tek STS (Mbrojtja Zvicerane e Kafshëve) ose tek BVET ose të shkarkohen nga Uebfaqja e BVET në formatin PDF, www.bvet.admin.ch dhe www.tiererichtighalten.ch.
- Certodog, Stiftung für das Wohl des Hundes (Fondacion për mirën e qenit), Gugelmattstr. 36, 8967 Widen, Tel. 056 631 80 18, Faksi: 056 631 80 18, info@certodog.ch, www.certodog.ch, Certodog - dy shenja për mbajtje të kontrolluar të qenve, Kualifikim i mëtejshëm për mbajtësit e qenve.
- Schweizerische Kynologische Gesellschaft (Shoqëria zviceran e kinologëve) SKG, Länggassstrasse 8, Postfach 8276, 3012 Bern, Tel. 031 306 62 62, Faksi: 031 306 62 60, www.skg.ch, info@skg.ch, Etiketa e artë e kontrollit të cilësis („Goldenes Gütesiegel“), kurse edukues, shkollim dhe kualifikim i mëtejshëm për mbajtësit e qenve.
- Kynologos AG, Gesellschaft für angewandte Verhaltensforschung bei Hunden (Shoqëri për hulumtimin e aplikuar të sjelljeve tek qenët), Habersaat, 8914 Aeugstertal, Tel. 044 776 11 87, Faksi: 01 776 11 89. Ditët origjinale për lojë dhe formim të këlyshëve („Original-Welpenprägungsspieltage“), kualifikim i mëtejshëm për mbajtësit e qenve.

Redaktor:
Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, 4008 Basel,
Tel. 061 365 99 99, Fax 061 365 99 90, www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com